

Shërbime të shtetit plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3299 Prot.

Tiranë, më 30 Gusht 2024

Lënda: Kërkesë për interpelancë urgjente me kryeministrin Edi Rama

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Baza Ligjore: Neni 80, pika 1 e Kushtetutës
Neni 97 i Rregullores së Kuvendit

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Në 8 gusht 2024, tre organizata ndërkombëtare të mjedisit denoncuan faktin se dy anije të nisura nga Porti i Durrësit, po transportonin lëndë të rrezikshme drejt Azisë. Anijet ishin nisur në korrik, pa konfirmim se vendi pritës, Tajlanda, do t'i pranonte. Kur qeveria e Tajlandës mësoi për llojin e ngarkesës që transportonin anijet, refuzoi t'i pranonte në territorin e saj, siç raporton media amerikane Bloomberg, që ishte e para që raportoi për skandalin.

Ngarkesa në fjalë sipas organizatave mjedisore është pluhuri i furrës, një produkt mbetjesh i rrezikshëm që zakonisht vjen nga riciklimi i skrapit të çelikut dhe përmban okside metalike toksike si kadmiumi dhe kromi, që janë të dëmshëm për shëndetin dhe mjedisin. Ky lloj pluhuri kërkon trajtim të kushtueshëm, dhe për këtë arsye kompanitë që e prodhojnë kërkojnë të shmangin shpenzimet. Aktualisht, dy anijet me 100 kontenierë që mbajnë rreth 816 ton mbetje brenda tyre po kthehen në Durrës.

Organizata jo qeveritare amerikane 'Rrjeti i Aksionit të Bazelit' i tha Zërit të Amerikës, se ajo është e bindur se porti i Durrësit, jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera më parë është shfrytëzuar për të nxjerrë nga Shqipëria, rajoni dhe me gjasë edhe nga vende të tjera evropiane, mbetje të rrezikshme helmuese drejt disa vendeve aziatike. Për këtë organizatë prestigjioze ndërkombëtare, nga Porti i Durrësit, çdo tre apo katër muaj është eksportuar një material që dyshohet se është pluhur helmues i njohur si 'EAF', që del nga oxhaqet e fabrikave metalurgjike. Përfaqësuesi i kësaj organizate, z. Jim Puckett tha se pas marrjes së të dhënave, BAN-i ka kryer hulumtimin e veta dhe arrin në përfundimin se dërgesa të kësaj natyre bëhen rregullisht nga Porti i Durrësit.

Për sasinë e konstatuar së fundmi, dyshimet e arsyeshme të deri tanishme tregojnë se hiri i eksportuar nga porti i Durrësit i takon firmës "Sokolaj" e cila e ka blerë atë nga fabrika e kompanisë "Kurum International" sh.a. në Elbasan që prodhon çelik dhe hekur. Firma "Sokolaj" rezulton që në mars të

vitit 2022 ka marrë licencë për transportin e lëndëve të rrezikshme nga Ministria përgjegjëse për mjedisin. Por, përfaqësuesi i organizatës jo qeveritare amerikane ‘Rrjeti i Aksionit të Bazelit’, z. Puckett thotë se eksportimi i shpeshtë i këtij materiali nga Durrësi, ngre dyshime që ai nuk vjen vetëm nga fabrika e Kurimit, pasi kjo fabrikë nuk është aq e madhe sa të prodhojë sasi kaq të mëdha të pluhurit EAF.

Një tjetër ngakesë sipas “Rrjetit të Aksionit të Bazelit” është dërguar po gjatë këtij viti, në muajin Prill, nga Porti i Durrësit për në Kinë, dhe që gjithashtu rezultoi që të jetë e bllokuar në një port kinez, afër Hong Kongut. Autoritetet kineze, kanë analizuar 115 kontejnerët e nisur nga Shqipëria dhe kanë gjetur nivele të larta të metaleve, përfshirë mbi 8% plumb.

Gjithashtu, në mediat shqiptare janë publikuar edhe fotografi nga ambinetet e Portit të Durrësit ku shihen grumbuj të hirit që ishin lënë në mjedis të hapur, edhe pse bëhet fjalë për një mbetje të rrezikshme, që nëse nuk trajtohet si duhet, shkakton probleme serioze në jetën dhe shëndetin e qytetarëve. Pluhuri EAF përmban përqindje të lartë metalesh si plumbi dhe kromi dhe mbetje të tjera kimike që shkaktojnë kancer. Sipas BAN-it pasojat janë të rënda, për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

Lidhur me këtë çështje ka patur disa reagimi konfuze apo kontradiktore të disa prej institucioneve përgjegjëse, disa ditë me vonesë, duke përfshirë reagimin e Ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, Portin e Durrësit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj.. Ndërkohë, një hetim i dyfishtë është duke u kryer nga prokuroria e Durrësit në Shqipëri dhe nga zyra e Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve, OLAF, në Bruksel, mbi 100 kontejnerë të bllokuar së fundmi në Singapor, me origjinë nga porti i Durrësit.

Në këtë mënyrë ka dyshime serioze se Shqipëria ka shkelur Konventën e Bazelit, Traktatit të Kombeve të Bashkuara, që rregullon tregtinë e mbetjeve të rrezikshme. Vendet nënshkruese të konventës, një prej të cilave është edhe Shqipëria, nuk lejohen të dërgojnë mbetje helmuese tek një vend tjetër, nëse nuk marrin paraprakisht miratimin nga vendi mikpritës.

Rastet e përsëritura të konstatuara ngenë dyshime serioze se Shqipëria është përfshirë në një tregti të paligjshme ndërkombëtare të mbetjeve të rrezikshme. Kjo tregon se nuk kemi të bëjmë me një ngjarje të izoluar, por me një aktivitet të mirëfilltë kriminal, që përfshinë përgjegjësi për veprime të paligjshme apo mosveprime të disa autoriteteve shtetërore në varësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe një mungesë neglizhence kriminale të mbikëqyrjes së aktivitetit të paligjshëm të disa subjekteve tregtare private (të identifikuar deri më tani kompanitë “Kurum International” sh.a. dhe “Sokolaj” sh.p.k.). Për këtë shkak, vetëm për dy ngarkesat e identifikuar rezultoi se në Shqipëri do të rikthehet një sasi në minimum prej rreth 1600 ton mbetjesh toksike, të patrajtuara dhe të papërpunuara, që rrezikojnë të kanosin jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe pa dyshim sigurinë kombëtare.

Nga të dhënat e mësipërme, deri më tani rezulton dyshimi i arsyeshëm se është cenuar interesi publik, për shkak se:

- Kompania “Kurum International” sh.a. ka shkelur ligjin për mënyrën e përpunimit të mbetjeve të rrezikshme që prodhon, ndërkohë që kompania “Sokolaj” sh.p.k. ka shkelur ligjin lidhur me transportin e mbetjeve toksike të rrezikshme.
- Autoritetet përgjegjëse kanë shkelur ligjin duke mosvepruar ndaj këtyre shoqërive private për përpunimin apo transportin e mbetjeve toksike, si dhe duke lejuar eksportin e tyre jashtë territorit në shkelje të ligjeve të vendit dhe konventave ndërkombëtare.
- Nga ana tjetër, Qeveria dhe autoritetet përgjegjëse heshtin prej 3 javësh dhe nuk veprojnë duke mos bërë asnjë transparencë mbi këtë çështje, ndërkohë që skandali ka marrë përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këto kushte, me qëllim dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me sa më lart, në kushtet kur çështja përfshinë veprimin apo mosveprimin e disa ministrive dhe institucioneve përgjegjëse, si dhe një neglizhencë të papranueshme për të mbikëqyrur aktivitetet e paligjshme të subjekteve private, në mbështetje të nenit 80, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 97, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë zhvillimin e një interpelance urgjente me kryeministrin Edi Rama, në seancën plenarë më të parë.

Duhet menjëherë dhe pa asnjë vonesë që Qeveria Shqiptare të informojë Kuvendin e Shqipërisë, dhe përmes tij edhe opinionin publik se për çfarë bëhet fjalë, kujt i përkasin mbetjet e rrezikshme, si janë krijuar apo kanë mbërritur në Shqipëri, si janë trajtuar, çfarë veprimesh, kontrollesh apo aktesh mbikëqyrëse kanë ndërmarrë institucionet, si janë lejuar të eksportohen pa lejet përkatëse nga Porti i Durrësit, kush i ka lejuar të futen dhe të dalin prej territorit të Republikës së Shqipërisë, nga dhe përmes Portit të Durrësit, etj. Në këtë rast mungesa e transparencës nga ana e Qeverisë shton edhe më shumë pasigurinë për jetën e qytetarëve shqiptarë dhe mbi të gjitha dyshimet për një aktivitet kriminal me leje shtetërore, që rrezikon sigurinë kombëtare të një vendi anëtar të NATO-s.

Përsa më lart, kërkojmë përfshirjen e kësaj çështje në rendin e ditës të seancës përkatëse plenare dhe njoftimin e Kryeministrit mbi detyrimin për të qenë prezent personalisht në seancë.

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI**

Gazment BARDHI

